



Pranim / Dorezuar Priliceno / Priliceno Received / Delivered	25.03.2022	2	viti god year
Organ / Bjesia Organ / Jedinica Org / Unit	1613/2022	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHK			1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.115/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Arditë Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.115/2022 të datës 11.02.2022 të parashtruar nga ankuesja

Prishtinë, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.115/2022 e datës 11.02.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës për vitin 2021, i datës 27.01.2022, lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen nga nota mjaftueshëm (2.3) në notën e përgjithshme mirë (3).
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Punës si në pikën 2 të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja, nëpunëse civile në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 11.02.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 684/2022, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejt nuk është real dhe nuk janë përfillur kërkesat ligjore që derivojnë nga Rregullorja Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (me tej referuar Këshilli) me datë 18.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit me datë 24.02.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses e datës 11.02.2022 me Nr.Prot:684/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 21.12.2021; Klasifikimet për periudhën janar-qershor 2021; Planin vjetor të punës të Departamentit për kontrollin e tregut me mallra strategjike për vitin 2021; E-mailin zyrtar të datës 18.12.2020; E-mailin zyrtar të datës 16.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.12.2020; Planin vjetor të punës për vitin 2021 të Departamentit për kontrollin e tregut të mallrave strategjike; Vlerësimin vjetor të punës për vitin 2021 për ankuesen i datës 27.01.2022; Vlerësimin vjetor të punës për vitin 2021 për ankuesen; E-mailin zyrtar të datës 20.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 20.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 20.12.2021; Raportin vjetor për periudhën janar-dhjetor për vitin 2021; Dëshmi lidhur me regjistrimet, licencimet dhe inspektimet për periudhën janar-dhjetor; E-mailin zyrtar të datës 22.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 21.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 20.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 15.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 15.10.2021; E-maili zyrtar i datës 28.10.2021; E-maili zyrtar i datës 23.12.2021; E-maili zyrtar i datës 25.11.2021; E-maili zyrtar i datës 23.11.2021; E-maili zyrtar i datës 03.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 13.07.2021; E-mailin zyrtar të datës 02.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 25.10.2021; E-mailin zyrtar të datës 29.09.2021; E-mailin zyrtar të datës 28.05.2021; E-mailat zyrtar të datës 25.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 22.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.09.2021; E-mailat zyrtar të datës 22.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 24.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 22.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 28.01.2022; E-maili zyrtar i datës 16.09.2021; E-maili zyrtar i datës 01.09.2021; E-maili zyrtar i datës 01.12.2021; E-maili zyrtar i datës 06.04.2021; E-maili zyrtar i datës 09.03.2021; E-maili zyrtar i datës 03.06.2021; E-maili zyrtar i datës 12.01.2022; E-mailat zyrtar të datës 15.07.2021; E-maili zyrtar i datës 02.08.2021; E-maili zyrtar i datës 30.03.2021; E-mailat zyrtar të datës 22.10.2021; E-maili zyrtar i datës 15.12.2021; E-maili zyrtar i datës 01.11.2021; E-maili zyrtar i datës 01.04.2021; E-mailat zyrtar të datës 27.10.2021; E-maili zyrtar i datës 15.12.2021; E-maili zyrtar i datës 14.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 22.11.2021; E-mailat zyrtar të datës 30.09.2021; E-maili zyrtar i datës 10.11.2021; E-maili zyrtar i datës 04.11.2021; E-maili zyrtar i datës 15.09.2021; E-maili zyrtar i datës 12.02.2021; E-maili zyrtar i datës 22.02.2022; E-maili zyrtar i datës 24.12.2021; E-maili zyrtar i datës 21.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 30.11.2021; E-mailat

zyrtar të datës 04.11.2021; E-maili zyrtar i datës 21.12.2020; E-mailat zyrtar të datës 28.12.2021; E-maili zyrtar i datës 20.10.2021; E-maili zyrtar i datës 20.10.2021; E-maili zyrtari datës 19.10.2021; E-maili zyrtar i datës 15.12.2021; E-maili zyrtar i datës 02.11.2021; E-maili zyrtar i datës 15.11.2021; E-maili zyrtar i datës 12.11.2021; E-mailat zyrtar të datës 02.06.2021; E-maili zyrtar i datës 10.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 09.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 06.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 30.11.2021; E-maili zyrtar i datës 14.12.2021; E-maili zyrtar i datës 13.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 23.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 20.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 20.09.2020; E-maili zyrtar i datës 08.09.2021; E-mailat zyrtar të datës 30.11.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 03.08.2021; E-maili zyrtar i datës 24.12.2021; E-maili zyrtar i datës 04.11.2021; E-mailat zyrtar të datës 26.10.2021; E-maili zyrtar i datës 07.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 06.10.2021; E-maili zyrtar i datës 04.10.2021; E-maili zyrtar i datës 01.10.2021; E-maili zyrtar i datës 30.09.2021; E-maili zyrtar i datës 15.09.2021; E-maili zyrtar i datës 31.05.2021; E-mailat zyrtar të datës 31.05.2021; E-mailat zyrtar të datës 27.05.2021; E-maili zyrtar i datës 23.03.2021; E-maili zyrtar i datës 26.11.2021; E-mailat zyrtar të datës 09.12.2021; E-mailat zyrtar të datës 14.12.2021; E-maili zyrtar i datës 15.12.2021; E-maili zyrtar i datës 23.12.2021; E-maili zyrtar i datës 13.09.2021; E-mailat zyrtar të datës 13.09.2021; Certifikatën e muajit shtator 2021; E-maili zyrtar i datës 11.05.2021; Emaili zyrtar i datës 05.05.2021; Ftesën e datës 15.09.2021; E-mailat zyrtar të datës 19.04.2021; E-mailat zyrtar të datës 16.12.2021; E-maili zyrtar i datës 15.12.2021; E-maili zyrtar i datës 08.12.2021; E-maili zyrtar i datës 04.11.2021; E-maili zyrtar i datës 27.10.2021; E-maili zyrtar i datës 26.08.2021; E-maili zyrtar i datës 21.07.2021; E-mailat zyrtar të datës 26.08.2021; E-mailat zyrtar të datës 30.11.2021; E-maili zyrtar i datës 18.11.2021; E-maili zyrtar i datës 22.12.2021; E-maili zyrtar i datës 22.12.2021; E-maili zyrtar i datës 04.10.2021; E-maili zyrtar i datës 24.02.2021; E-maili zyrtar i datës 22.02.2021; E-maili zyrtar i datës 15.02.2021; E-maili zyrtar i datës 18.08.2021; E-maili zyrtar i datës 31.12.2021; E-maili zyrtar i datës 10.11.2021; E-maili zyrtar i datës 28.01.2022; E-maili zyrtar i datës 27.01.2022; Vendimin me numër 01.Ref.Nr.04 të datës 06.01.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.74 të datës 08.03.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.193 të datës 08.10.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.213 të datës 25.10.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.266 të datës 22.11.2021; E-maili zyrtar i datës 28.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit të datës 29.07.2019, është e punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pozitën e punës *Zyrtar për mallra me përdorim të dyfish*, në kuadër të Departamentit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike.

Udhëheqësi i Divizionit për mallra me përdorim të dyfishtë në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 27.01.2022 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankueses për vitin 2021, duke e vlerësuar të njëjtën lidhur me objektivat e punës me notë mesatare 2.7 kurse për aftësitë e përgjithshme me notë mesatare 1.8, respektivisht me notën e përgjithshme 2.3 që në kuptim të nenit 11 par grafi 1 nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.

21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike nënkupton vlerësimin "kënaqshëm apo mjaftueshëm".

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim, brenda afatit ligjor parashton ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejt nuk është real dhe nuk janë përfillur kërkesat ligjore që derivojnë nga Rregullorja Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Tutje shton se asnjëherë nuk ka marrë ndonjë vërejtje me gojë ose me shkrim për mos kryerjen e detyrave të saj nga ana e udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë, dhe se e njëjta deklaron se përveç detyrave të saj të cilat i ka kryer me përkushtim, ka kryer edhe detyra të tjera shtesë të cilat i janë deleguar madje edhe detyra që kanë qenë të udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë për ti kryer, e njëjta kërkon që në bazë të meritokracisë dhe ligjshmërisë nga ana e Këshillit ankesa e saj të miratohet si e bazuar.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësies apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimin në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar).*, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja përkundër mungesës së hartimit të Planit Individual të punës për vitin 2021 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, e njëjta sipas Raportit vjetor të punës për vitin 2021 të dorëzuar tek mbikëqyrësi i saj, ka pasqyruar aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së vlerësimit, duke listuar këto aktivitete për secilën fushë veç e veç si në vijim: tek fusha e regjistrimit thekson se ka pranuar dhe shqyrtuar tridhjetegjashtë (36) kërkesa të parashtruara nga kompanitë për regjistrim, tek fusha e licencimit ka pranuar dhe shqyrtuar njëqindetë (108) kërkesa për licencim të tregtisë me mallra strategjike, tek fusha e kthimit të licencave dhe raportimet ka pranuar kthimin e 103 licencave, po ashtu e njëjta ka përmendur faktin se pergjatë vitit 2021 ka marrë pjesë në komisione të ndryshme në kuadër të ministrisë si dhe ka qenë pjesëmarrëse në disa grupe punuese/trajnime online, andaj, bazuar në këto rrethana si dhe duke marrë parasysh komunikimet që ankuesja ka pasur me udhëheqësin e saj lidhur me përmbushjen e detyrave të saj, Kolegji vlerëson se e njëjta ka arritur ti kryej dhe përmbushë objektivat e saj të punës.*

Kolegji po ashtu ka analizuar edhe përgjigjen e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses dhënë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.02.2022, i cili ka deklaruar se: *me ankuesen asnjëherë nuk ka mbajtur takime formale zyrtare ngase janë në një zyre të*

vogël bashkarisht, se ankuesja sipas tij realizimin e aktiviteteve të detyrave të punës asnjëherë nuk e ka pasur në nivel të kënaqshëm, se ndaj të njëjtës vazhdimisht ka pasur vërejtje verbale për mos përmbushjen e detyrave të punës, mirëpo, ndërlidhur me këtë, Kolegji në shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë provë materiale lidhur me faktin së Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka shprehur pakënaqësi lidhur me mos kryerjen e detyrave të punës nga ana e ankueses, te këtë shqiptuar vërejtje në raport me mos përmbushjen e detyrave të punës apo se i njëjti ka kontribuar përmes dhënies së sugjerimeve dhe këshillave lidhur me përmirësimet e nevojshme të ankueses në përmbushjen e objektivave të punës, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike në të cilën precizohet se : *Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme”, e si me lartë rezultojnë se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka pasur për detyrë që përgjatë gjithë vitit të përcjellë përmbushjen e detyrave nga ankuesja dhe të kërkojë nga e njëjta që te raportoj në baza javore apo mujore lidhur punët e realizuara.*

Nisur si me lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se:... 4. *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit), Kolegji ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2021, për ankueser ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare dy pikë tre (2.3), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare tre (3), e që në kuptim të nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafin 2 nënparagrafin 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin “mirë” konkretisht mirë nënkupton se nëpunësi ka realizuar objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës.*

Andaj, nisur nga konstatimi si me lartë se ankuesja ka përmbushur objektivat e punës, Kolegji vlerëson se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimit. .


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.115/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretariat te Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

